



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Prishtinës
Pristina Obstina-Municipality of Pristina



SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61.3. lidhur me nenin 62 paragrafi 62.1 nënparagrafi d) si dhe nenin 63 paragrafi 63.1 nënparagrafi 63.1.1 të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik "Ejona" Sh.P.K. të datës 15.08.2023 kundër njoftimit mbi vendimin e datës 11.08.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Regullimi dhe riparimi i ashensorëve" me nr. të prokurimit 616-22-2435-2-1-1 dhe nr. të brendshëm 616-22-026-211, Komuna e Prishtinës (autoriteti kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. **REFUZOHET** kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik "Ejona" Sh.P.K. e datës 15.08.2023 kundër njoftimit mbi vendimin të datës 11.08.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Regullimi dhe riparimi i Ashensorëve" me nr. të prokurimit 616-22-2435-2-1-1 dhe nr. të brendshëm 616-22-026-211.
- II. **AUTORIZOHET** autoriteti kontraktues - Komuna e Prishtinës që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit të përcaktuar si në pikën I të këtij vendimi.
- III. **NJOFTOHET** operatori ekonomik "Ejona" Sh.P.K. si dhe të gjitha palët tjera të interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën elektronike E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Operatori ekonomik "Ejona" Sh.P.K. (tutje "parashtruesi") me datë 15.08.2023 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit mbi vendimin e datës 11.08.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Regullimi dhe riparimi i Ashensorëve" me nr. të prokurimit 616-22-2435-2-1-1 dhe nr. të brendshëm 616-22-026-211.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin meritor (*in meritum*) të kërkesës.

Pretendimet e parashtruesit janë cituar si në vijim:

- **Pretendimi i parë (I):** "Lideri i grupit që parashihet ti kryej punimet në këto aktivitete, nuk është i licensuar me ISO 9001 për mirëmbajtjen e ashensoreve. Mirepo, për të përmbushur kërkesën e AK, ka krijuar konzorcium me OE Inrast i cili është i paisur me ISO 9001".
- **Pretendimi i dytë (II):** "OE i shpallur fitues ka dorëzuar Sigurimin e tenderit vetëm në emër të liderit "UP Lift" por jo edhe të partnerit "INTRAST". Sipas Nenit 57, sigurimi i tenderit është i domosdoshëm për të gjithë tenderuesit e jo vetëm për lideret e grupit".
- **Pretendimi i tretë (III):** "OE i shpallur fitues nuk ka përmbushur kërkesat e pershtatshmerisë profesionale përkatësisht kërkesën c. 3 ekipe me nga 2 teknikë - minimumi 3 vite përvojë pune në punë të ngjashme - 2.CV-a, Diploma, Kontrata e punës me punëdhënësin ose marrëveshja mbi angazhimin për këtë projekt".
- **Pretendimi i katërt (IV):** "Grupi i OE "UP LIFT & INTRAST SHPK" & OE "HYMERI KLEEMANN" kanë shkelur Nenin 71 paragrafin 2 të LPP" (kjo pasi që sipas parashtruesit pronari/drejtori menaxhues i operatorit ekonomik Uplift Sh.P.K dhe tenderuesit Hymeri Elevator Sh.P.K është personi i njëjtë).
- **Pretendimi i pestë (V):** "AK ka shkelur Nenin 5 dhe Nenin 42 duke shpallur Vendimin e AK me datën 11.08.2023 në ora 16:02 dhe cuditerisht kjo ditë i bie të jetë e premte që kalkulohet si dita 1. Në mënyrë të kërkuar qasje në dokumentacionin shtesë dhe nuk marrim përgjigje nga AK deri ditën e parafundit, ku na lejohet qasja ditën e marte në ora 11:00 e cila cuditerisht është dita e fundit për Kërkesën për Rishqyrtim. Pra, AK ka shkelur këto dispozita duke publikuar Njoftim për vendim PAS ORARIT LIGJOR TË PUNES. Kjo është e papranueshme dhe shumë jo-korrekte nga ana e AK".

Duke u referuar të pretendimet si më sipër, parashtruesi konsideron se autoriteti kontraktues ka shkelur nenin 5, 26, 28, 38, 59, 66, 71 dhe të LPP.

Autoriteti Kontraktues - Komuna e Prishtinës përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit me datë 22.08.2023 ka trajtuar kërkesën e parashtruesit për rishqyrtim.

Lidhur me pretendimin e parë (I) ankimor: fillimisht duhet cekur se në kuadër të kërkesave mbi kapacitetin teknik dhe profesional, kërkesa nr. 3 në dosjen e tenderit është përcaktuar si në vijim: "Operatori duhet të jetë i certifikuar sipas standardeve ISO 9001, ISO 14001 dhe ISO 18001". Pretendimi i parashtruesit ka të bëjë vetëm me certifikatën ISO 9001. Prandaj është administruar si provë dosja me të cilën ka ofertuar tenderuesi i rekomanduar ku ndër të tjera është gjetur se është dorëzuar edhe certifikata ISO 9001 sikurse është kërkuar me dosjen e tenderit. Në fakt as për parashtruesin nuk është kontestuese që tenderuesi i rekomanduar e ka plotësuar këtë kërkesë të dosjes së tenderit. Pjesa kontestuese e pretendimit të tij ka të bëjë me faktin që kjo certifikatë i përket njërit nga operatorët ekonomik që është pjesë e tenderuesit si grup i operatorëve ekonomik por jo edhe e liderit të grupit që është Uplift Sh.P.K. Lidhur me këtë pjesë të pretendimit ankimor duhet sqaruar që sipas LPP arsytet për të cilat lejohen grupet e operatorëve ekonomik që të dorëzojnë oferta kanë të bëjnë pikërisht me lejmimin e mundësisë që bashkarisht të përmbushin kërkesat e dosjes së tenderit të caktuar në rastet kur ata

individualisht nuk kishin për të mundur që t'i përmbushin. Nga ky këndvështrim edhe parashtruesi ka pasur mundësinë që të themeloj një grup të operatorëve ekonomik në mënyrë që i njëjti të përmbushë më mirë kërkesat e dosjes së tenderit. Sidoqoftë, kërkesa të cilës i referohet pretendimi ankimor derivon nga neni 69 i LPP lidhur me aftësitë teknike dhe/ose profesionale të tenderuesve. Rrjedhimisht vlen të citohet neni 69 paragrafi 8 i LPP ku ndër të tjera përcaktohet se *"grup i operatorëve ekonomik mund të mbështetet në aftësitë e pjesëmarrësve në grup ose në subjekte të tjera"*. Në këtë drejtim RRPP është ende më konkret pasi që përmes nenit 24 paragrafit 24.5 ka përcaktuar se *"Çdo kërkesë e vendosur nga një autoritet kontraktues sipas nenit 66.2 (Autorizimi/Licenca), nenit 68 të LPP-se, gjendja ekonomike dhe financiare dhe nenit 69 të LPP-se aftësia teknike dhe/ose profesionale, do të aplikohen vetëm ndaj grupit si tërësi dhe jo ndaj anëtarëve individual të grupit"*. **Për këto arsye pretendimi i parë (I) ankimor është i pabazuar.**

Lidhur me pretendimin e dytë (II) ankimor: fillimisht duhet sqaruar se përmes dosjes së tenderit është kërkuar ndër të tjera edhe një evidencë të një police të sigurimit të lëshuar nga një kompani e njohur e licencuar e sigurimeve. Për parashtruesin nuk është fare kontestuese që tenderuesi i rekomanduar e ka dorëzuar dëshminë e policës së sigurimit sipas dosjes së tenderit. Mirëpo parashtruesi e konteston vetëm faktin që secili anëtar i grupit të operatorëve do duhej të depononte nga një policë të sigurimit përmes ofertës dhe nuk mjafton që siguria e tenderit të dorëzohet vetëm në emër të liderit të grupit të operatorëve ekonomik. Në këtë drejtim duhet potencuar se kjo kërkesë e dosjes së tenderit bazohet në nenin 68 të LPP ku përcaktohet se autoriteti kontraktues mund të kërkoj nga tenderuesit ndër të tjera edhe *"një evidencë të një police të sigurimit të lëshuar nga një kompani e njohur e licencuar e sigurimeve"*. Në kontekst të pretendimit ankimor duhet cituar edhe paragrafin 4 të nenit 68 ku përcaktohet ndër të tjera se *"një grup i operatorëve ekonomik mund të mbështetet në kapacitetet e pjesëmarrësve në grup të subjekteve të tjera"*. Duhet marrë parasysh edhe nenin 24 paragrafin 24.5 të RRPP të cituar më sipër ku thuhet se kërkesat nga neni 68 i LPP do të aplikohen vetëm nga grupit si tërësi dhe jo ndaj anëtarëve individual. **Për këto arsye pretendimi i dytë (II) ankimor është i pabazuar.**

Lidhur me pretendimin e tretë (III) ankimor: duhet sqaruar se ky pretendim i parashtruesit është trajtuar edhe përmes vendimi të OSHP të datës 23.12.2022 me nr. PSH.nr. 522/22 ku në faqen nr. 3 të këtij vendimi Paneli Shqyrtues në pjesën e arsyetimit lidhur me këtë pretendim i ka falur besimin e plotë ekspertës shqyrtuese dhe ka gjetur se ky pretendim është pabazuar. Me këtë rast ndër të tjera Paneli Shqyrtues ka gjetur se *"OE ankues Uplift LLC and Intrast Sh.P.K ka ofruar listën e punëtorëve me gjithsej 13 punëtor ku në bazë të kësaj liste rezulton se i njëjti ka ofruar 11 teknik. Andaj arsyetimi i AK për eliminimin e Uplift L.L.C & Intrast Sh.P.K. nuk qëndron"*. Duke marrë parasysh vendimin e cituar më sipër të OSHP është gjetur se pretendimi i tretë (III) ankimor është i pabazuar. Në fakt përsëritja e këtij pretendimi nga parashtruesi është e palejuar dhe në kundërshtim me nenin 108/A të LPP pasi që ky pretendim është shqyrtuar një herë nga OSHP dhe nuk ka nevojë që të shqyrtohet sërish nga autoriteti kontraktues.

Lidhur me pretendimin e katërt (IV) ankimor: nuk është kontestues fakti që në këtë aktivitet të prokurimit përveç tenderuesit të rekomanduar ku lider i grupit është Uplift Sh.P.K. ka dorëzuar ofertë edhe tenderuesi "Hymeri Elevators" Sh.P.K. Së këndejmi parashtruesi pretendon se pronar/drejtor menaxhues i të dy këtyre tenderuesve është personi i njëjtë në kundërshtim me nenin 71 paragrafin 2 të LPP ku përcaktohet se "Në rast së një anëtar merr pjesë në disa grupe, secili nga grupet përkatëse do të konsiderohen të papërshtatshëm". Me këtë rast parashtruesi përmes kërkesës për rishqyrtim ka prezantuar disa kontrata ku figurojnë disa email adresa (adresa elektronike) duke aluduar se tenderuesit në fjalë shfrytëzojnë emailin e njëjtë prandaj pronari i tyre i është i njëjtë. Natyrisht se ky argument nuk është i bazur në dokumente zyrtare dhe relevante të lëshuara nga ARBK prandaj edhe ky argument është jo vetëm i paqëndrueshëm por edhe tërësisht joserioz dhe joprofesional.

Sidoqoftë, nga certifikatat e biznesit që kanë dorëzuar këta dy tenderues por edhe nga të dhënat publike në sistemin elektronik të ARBK është konfirmuar se pronar, drejtor menaxhues dhe përfaqësues i autorizuar sipas ligjit në Hymeri Elevators Sh.P.K. është Hysni Ymeri. Në anën tjetër ky person nuk ka asnjë pozitë dhe nuk është fare punonjës i operatorit ekonomik Uplift Sh.P.K. sikurse pretendon parashtruesi. Konkretish në Uplift Sh.P.K. drejtor menaxhues është Bardh Hoti ndërsa zv. drejtor është Florid Neziraj. Të dy këta përveç që janë përfaqësues të autorizuar janë edhe pronar/ aksionar me nga 16.67%. Pronarët/ aksionarët tjerë me përqindjen e njëjtë (nga 16.67%) janë po ashtu Fatos Maloku, Arbër Sadiku, Fidan Latifi si dhe Besart Koqinaj. **Për këto arsye pretendimi i katërt (IV) ankimor është i pabazuar.**

Lidhur me pretendimin e pestë (V) ankimor: së pari duhet potencuar se ky pretendim është kundërthënës pasi që parashtruesi në njërën anë konfirmon se autoriteti kontraktues ka miratuar kërkesën e parashtruesit për qasje në dokumente zyrtare brenda afatit të lejuar dhe në anën tjetër pretendon se autoriteti kontraktues ka shkelur nenin 5 dhe 42 të LPP pasi që ka publikuar njoftimin mbi vendimin në ora 16:02 përkatësisht 2 minuta pas orarit zyrtar të punës për shërbyesit civil.

Duhet cekur se neni 42 i LPP nuk ka të bëjë fare me këtë pretendim pasi që rregullon bashkëpunimin ndërmjet autoritetit kontraktues dhe KRPP me rastin e publikimit të një njoftimi të caktuar. Ndërsa neni 5 i LPP të cilit i referohet parashtruesi nuk e ndalon aspak autoritetin kontraktues që të publikoj njoftimin mbi vendimin edhe pas orës 16:00 gjatë ditëve të punës. Përkundër faktit që janë në pyetje vetëm 2 minuta, në raste të tilla ky fakt mund të merret parasysh në zgjatjen e afateve për tenderuesit për paraqitjen e kërkesave për qasje në dokumentet zyrtare ose për kërkesat për rishqyrtim. Mirëpo ky fakt nuk është fare kontestues për parashtruesin pasi që vet e konfirmon se autoriteti kontraktues e ka miratuar kërkesën për rishqyrtim brenda afatit të përcaktuar ligjor. **Rrjedhimisht pretendimi i pestë (V) ankimor është i pabazuar.** Mirëpo edhe po të ishte i bazuar, ky pretendim është tërësisht jorelevant pasi që ka të bëjë me një çështje krejtësisht teknike dhe nuk ndikon aspak në qëllimin apo në rezultatet e aktivitetit të prokurimit.

Duhet cekur se lidhur me këtë aktivitet të prokurimit ekzistojnë edhe dy (2) vendime të OSHP dhe atë vendimi i datës 21.03.2023 me nr. OSHP:2023/0141 si dhe vendimi i datës 23.12.2022 me nr. PSH.nr.522/22. Në këtë drejtim vendimi i autoritetit kontraktues lidhur me tenderuesin e rekomanduar është në përputhje të plotë me këto dy (2) vendime të OSHP. Ky fakt nuk është kontestuar as nga vet parashtruesi në kërkesën e tij për rishqyrtim. Përndryshe ky aktivitet i prokurimit ka një rëndësi të posaçme për banorët e Komunës së Prishtinës përkundër faktit që është stërzgatur pasi që ka filluar qysh në vitin 2022 dhe ende nuk ka përfunduar në vitin 2023.

Vlen të shtohet po ashtu se çmimi me të cilin ka ofertuar parashtruesi (9734.33) është rreth 36% më i shtrenjtë se çmimi me të cilin ka ofertuar tenderuesi i rekomanduar (625.95). Në këtë kontekst vendimi i autoritetit kontraktues është në përputhje të plotë edhe me parimin për ekonomicitet dhe ekonomizim sipas nenit 6 të LPP. Rrjedhimisht vendimi për tenderuesin e rekomanduar është në mbrojtje edhe të fondeve publike sipas nenit 1 të LPP si dhe interesit publik në kuptim të nenit 104 paragrafit 4 të LPP.

Në këtë mënyrë është gjetur se parashtruesi nuk ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pretendimet e tij. Njëkohësisht nga provat materiale të administruara është gjetur se të gjitha pretendimet e parashtruesit janë tërësisht të pabazuara. Prandaj kërkesa për rishqyrtim e parashtruesit është refuzuar si e pabazuar në tërësi.

Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.1.1. nënparagrafin b) lidhur me nenin 62 par. 62.1. nënparagrafin d) të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik.

Për pikën III dhe IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.2. të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Prishtinë, 22.08.2023

Visar SHEHU

Ud. Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit
Komuna e Prishtinës

Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.